

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje automjete dhe mjete teknologjike për mirëmbajtjen e linjave dhe nënstacioneve”, e ndarë në Lote si vijon:

Loti 1: Automjete tip SUV

Loti 2: Mjete teknologjike

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

34100000-8 - Automjete,

34136200-1 – Kamionçina;

VLERA E FONDIT LIMIT:

46,984,611 (dyzet e gjashtë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH, konvertuar në vlerën 465,056 (katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e pesëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH, sipas kursit të këmbimit datë 16.04.2024 (1 EUR = 101.03 ALL).

➤ Loti 1: Automjete tip SUV, me vlerë kontrate 21,384,611 (njëzet e një milion e treqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH, konvertuar në vlerën 211,665.9 (dyqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë nëntë) Euro pa TVSH, sipas kursit të këmbimit datë 16.04.2024 (1 EUR = 101.03 ALL).

➤ Loti 2: Mjete teknologjike, me vlerë kontrate 25,600,000 (njëzet e pesë milion e gjashtëqind) Lekë pa TVSH, konvertuar në vlerën 253,390 (dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e treqind e nëntëdhjetë) Euro pa TVSH, sipas kursit të këmbimit datë 16.04.2024 (1 EUR = 101.03 ALL).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti kontraktor **“Operatori i Sistemit te Transmetimit”**

(OST) sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT Loti 1: Automjete tip SUV

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 21,000,000 (njëzet e një milion) Leke.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohej që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros të jete në masën 21,000,000 (njëzet e një milion) Leke.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 8,500,000 (tete milion e pesëqind mije) Lekë pa TVSH.*

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se afërisht 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marre ne konsiderate sasine dhe cilesine e mallrave dhe sherbimet objekt procedure prokurimi, eshte menduar se vlera e kerkuar qe OE ofertues te kete bere me kontrata te ngjashme, te jete afer limitit maksimal dhe ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK.

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues, per automjetet qe do te paraqese, duhet te plotesoje tabelen e meposhtme, duke specifikuar vendin e origjines si dhe certifikimet e leshuara nga nje organ i autorizuar:*

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjines	Certifikate konformiteti ose cilesie CE/ekuivalent i akredituar
1			
2			
3			
4			

5			
6			
7			
8			
9			
10			

Argumentimi: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit, është vendosur në përputhje me pikën 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për automjetet tip SUV objekt prokurimi. Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrate, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën përkatëse të vlefshme ISO, (të perkthyer në shqip dhe të noterizuar) të leshuar nga organizmat e vleresimit të konformitetit, të akredituar nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:*

- *ISO 9001: për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, objekti i së cilës të këto lidhje me objektin e prokurimit.*

Argumentimi: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në bazë të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2502 Prot., datë 09.04.2021, si dhe ligjit nr.

116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se këto Certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi, sipas objektit të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Standarti i cilesise ISO 9001: është sot referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilesise të kompanive të të gjithë sektoreve dhe të gjithë permasave. Ky kriter kërkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Në lidhje me kërkesën që OE ofertues të paraqesë licencën e sipërcituar është menduar si i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, me qëllim për të siguruar AK që mallrat e ofruar do të jenë cilësorë dhe me parametra që plotësohen nga prodhues të licencuar sipas standardeve ndërkombëtare të cilesisë. Plotësimi i këtyre kriterëve nga ofertuesit e interesuar, garanton realizimin me sukses dhe me cilësi të objektit të kontratës.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit për automjetet tip SUV objekt prokurimi. Në katalog, të markohet në menyrë të qartë dhe të dallueshme artikulli që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të produktit që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse produkti i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

Argumentimi: Ky kriter është menduar për të dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.6 *Operatori ekonomik ofertues, për të mbuluar shërbimin e garancise së mjeteve objekt prokurimi, duhet të disponojë dhe të paraqesë listen e serviseve (në pronësi ose qira), të cilat detyrimisht duhet të jenë të pajisura me dokumentacion si vijon:*

- *Licence e lëshuar nga QKB me kategorinë VII.3.B.1 – “Riparimi dhe mirembajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat:
a – Riparimi dhe mirembajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;*

b – Riparimi dhe mirembajtja e karrocereve se mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

c – Riparimi dhe mirembajtja e impiantit elektrik te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

d – Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkiove.

ne perputhje me legjislacionin, per lejet dhe licencat, si dhe Udhezimin e Ministrise se Transportit dhe Infrastruktures Nr. 1546, date 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, per ambientin ku ushtron kete aktivitet.

➤ *Kontraten e qirase ne rastin kur OE nuk e ka ne pronesi te saj.*

Argumentimi: Ky kriter eshte menduar ne lidhje me sigurine e AK qe automjetet objekt kontrate do te kene sherbimin e nevojshem te ofruar nga OE ne rastin e sherbimit te garancise se kerkuar ne Dokumentet e Tenderit, ne perputhje me parashikimin e pikes 5 te nenit 40, te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne lidhje me licencen profesionale te OE ofertues, si sipas parashikimeve te Udhezimit Nr. 1546, date 29.03.2016, te Ministrise se Transportit dhe Infrastruktures.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese nje deklarate ku te specifikoje se: Automjetet tip SUV objekt procedure prokurimi jane të reja dhe të pa perdorura me parë.

Argumentimi: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të kete garanci që ofertuesi do të paraqesë mallrat objekt kontrate në cilësinë e kërkuar nga AK, eshte vendosur në përputhje me piken 6, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.8 Ne funksion te plotesimit te Shtojces 9 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i ketyre personave kerkon te dhëna te sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT Loti 2: Mjete teknologjike

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 25,000,000 (njëzet e pese milion) Leke.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohej që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros të jete në masën 25,000,000 (njëzet e pesë milion) Leke.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 10,000,000 (dhjete milion) Lekë pa TVSH.*

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 38 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilesine e mallrave dhe shërbimet objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues, për mjetet teknologjike që do të paraqesë, duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme, duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet e lëshuara nga një organ i autorizuar:*

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjinës	Certifikate konformiteti ose cilesie CE/ekuivalent i akredituar
1			
2			

Argumentimi: Ky kriter është menduar për të dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit, është vendosur në përputhje me pikën 6/, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese autorizimin e prodhuesit ose distributorit te autorizuar per mjetet teknologjike objekt prokurimi. Autorizimi i prodhuesit ose distributorit te autorizuar duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet te deklaroje Agregatet/Pajisjet/Pjeset e kembimit qe duhet te ofrohen sipas afateve te garancise te dhena nga prodhuesi ose distributori i autorizuar.*

Argumentimi: Te dhenat teknike te pjeseve qe jane ne garanci te prodhuesit per kembim, i japin sigurine AK qe OE ofertues eshte ne gjendje qe te realizoje kontraten sipas kushteve dhe kriterëve te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikaten perkatese te vlefshme ISO, (te perkthyer ne shqip dhe te noterizuar) te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituar nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si me poshte:*

- *ISO 9001: për Sistemin e Menaxhimit të Cilesise, objekti i se ciles te kete lidhje me objektin e prokurimit.*

Argumentimi: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne baze te Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se këto Certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për te kryer sherbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet

që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi, sipas objektit të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Standarti i cilesise ISO 9001: është sot referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilesise të kompanive të të gjithë sektoreve dhe të gjithë permasave. Ky kriter kërket nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Në lidhje me kërkesën që OE ofertues të paraqesë licencën e sipercituar është menduar si i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, me qëllim për të siguruar AK që mallrat e ofruar do të jenë cilësorë dhe me parametra që plotësohen nga prodhues të licencuar sipas standardeve ndërkombëtare të cilesisë. Plotesimi i këtyre kriterëve nga ofertuesit e interesuar, garanton realizimin me sukses dhe me cilësi të objektit të kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit për mjetet teknologjike objekt prokurimi. Në katalog, të markohet në menyre të qartë dhe të dallueshme artikulli që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të produktit që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse produkti i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Argumentimi: Ky kriter është menduar për të dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues, për të mbuluar shërbimin e garancise se mjetet teknologjike objekt prokurimi, duhet të disponojë dhe të paraqesë listen e serviseve (në pronësi ose qira), të cilat detyrimisht duhet të jenë të pajisura me dokumentacion si vijon:

➤ *Licence e lëshuar nga QKB me kategorinë VII.3.B.1 – “Riparimi dhe mirembajtja e pjeseve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat:*

a – Riparimi dhe mirembajtja e pjeseve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

b – Riparimi dhe mirembajtja e karrocërise se mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

c – Riparimi dhe mirembajtja e impiantit elektrik të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

d – Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkiove.

ne përputhje me legjislacionin, për lejet dhe licencat, si dhe Udhezimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturas Nr. 1546, datë 29.03.2016 “Autorizimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për ambientin ku ushtron këto aktivitet.

➤ *Kontratat e qirase në rastin kur OE nuk e ka në pronesi të saj.*

Argumentimi: Ky kriter është menduar në lidhje me sigurinë e AK që automjetet objekt kontrate do të kenë shërbimin e nevojshëm të ofruar nga OE në rastin e shërbimit të garancisë së kërkuar në Dokumentet e Tenderit, në përputhje me parashikimin e pikës 5 të nenit 40, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në lidhje me licencën profesionale të OE ofertues, si sipas parashikimeve të Udhezimit Nr. 1546, datë 29.03.2016, të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturas.

2.3.8 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të specifikojë se: Mjetet teknologjike objekt procedure prokurimi janë të reja dhe të pa përdorura më parë.*

Argumentimi: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të ketë garanci që ofertuesi do të paraqesë mallrat objekt kontrate në cilësinë e kërkuar nga AK, është vendosur në përputhje me pikën 6, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.9 *Në funksion të plotësimit të Shtojcës 9 “Formulari përmbledhës i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Atesë, Amësi, Datëlindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratoret e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.*

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Për këtë arsye, verifikimi i këtyre personave kërkon të dhëna të sakta si emër, mbiemër, atesë, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përlogaritur sasishtet e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik, i ndryshuar.